



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-11317/20 datë:03.07.2020



Npi – 01/162 datë: 08.07.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 08.07.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 08.07.2020 (e mërkurë) në ora 14.00 h. në sallën Nr.01.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rahman Kadrija, z.Muhamet Ademaj, znj.Diarta Vishesella, znj.Xhevahire Ramadani, z.Ruzhdi Brahimi, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Zyrtari Ligjor, z.Lulzim Muharremi; Zyrtari i IT-së Gazmend Ademaj; Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Draft-Programi Komunal Trevjeçar për banim 2020-2022, (pas diskutimit publik)
2. Draft-Rregullorja Komunale për Mbrojtjen e Fëmijës,
3. Informatë nga ZKKK-ja për aktivitetet,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Draft-Programi Komunal Trevjeçar për banim 2020-2022, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, ne i kemi ndjekur procedurat për diskutim publik, më 20 mars 2020. Siç e dini kam pas ndërprerje për shkak të Pandemisë KOVID19. Draft dokumentin e programit për banim e ka përgatitur Komisioni i themeluar nga Kryetari. Baza Ligjore ekziston. Në hartimin e këtij drafti kemi pas parasysh edhe dokumentet strategjike të Komunës siç janë PZHK dhe PZHU. Qëllimi është që ta kemi në dispozicion dokumentin bazik për sa i përket banimit të qytetarëve me nevoja më të mëdha dhe më të domosdoshme për banim.

Ky program është i hartuar për tri vite, ku edhe janë identifikuar familjet më në nevojë, dhe i kemi identifikuar 60 familje me nevoja më të mëdha dhe që kanë fëmijë. Më pastaj ne kemi bërë edhe klasifikimin e tyre ku 30 prej tyre kanë nevojë për objekt të banimit, ndërsa 30 të tjerët kanë objekte por që nevojitet meremetimi i këtyre objekteve. Më në hollësi i keni të gjitha të detajuara në dokument, që e keni marrë si draft-program për banim. Objektivi i këtij programi është për 16 njësi banimi, ku kemi

inkorporuar edhe vendimin e Kuvendit për ndarjen e një parcele për ndërtimin e një objekti për banim kolektiv në Lagjen e Pajtit.

Objekti tjetër është pranimi i një zyrtari, për të mbajtur një data bazë për çështje banimi. Për të ndërtuar këto njësi banimi kemi paraparë se nevojiten 326 mijë euro, për dy vite. Nga 130 mijë kemi paraparë me i siguruar Ministria për Komunitete dhe Kthim ose Qeveria e Kosovës dmth. për dy vite 260.000€, ndërsa Komuna me participu me nga 32.600€ dmth. për dy vite 65.200€.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, Unë desha të pyes se sa kanë të drejtë pjesëmarrje komuniteti pakicë në këtë projekt të banimit kolektiv?

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Të gjithë kanë të drejtë konkurrimi. Këtu nuk caktohet për ndonjë komunitet të caktuar por kriter sigurisht që do të jetë ata që i kanë kushtet më të vështira sociale e të banimit.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, e falënderoj Ibrahimin për këtë informatë. Unë besoj se Programi për banim do të aprovohet në Kuvend. Është mirë për familjet që janë me nevoja më të mëdha. Unë mendoj se do të ishte mirë që shuma financiare e programit për banim të futej në KAB, dhe mendoj se do të duhej të procedohej dhe të shikohet mundësia e financimit meqenëse ende nuk është aprovuar buxheti për vitin 2021.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -V- për vitin 2020, të mbajtur më: 08.07.2020, unanimitisht i rekomandon, Kuvendit të Komunës së Shtimes aprovimin e Draft-Programit Komunal trevjeçar për banim 2020-2022.**

Pika 2

Draft-Rregullorja Komunale për Mbrojtjen e Fëmijës

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Këtë Draft-Rregullore për Mbrojtjen e Fëmijës e ka përgatitur Zyra e Kryetarit. Unë mund të them se me këtë rregullore bëhet një avancim i të drejtave të fëmijëve, që përveç të drejtave ka edhe përgjegjësi, qoftë te prindërit qoftë te Institucionet shtetërore. Fëmija duhet të ketë qasje të barabartë në të gjitha fushat, mu për këtë arsye edhe është quajtur dokument miqësor për fëmijët. Janë të obliguara të gjitha Institucionet që ta kanë në qendër të vëmendjes interesin dhe barazinë e fëmijës. Për këtë arsye duhet të kemi një mekanizëm të posaçëm për mbrojtjen e fëmijëve. Rolin kryesor do ta ketë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Qendra për Punë Sociale duhet të ketë një Plan të Punës për këtë. Duhet të ndihmojë edhe Zyra Komunale për të Drejtat e Njeriut.

znj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, e falënderoj Ibrahimin për prezantimin e kësaj Draft-Rregullore për fëmijë. Ky dokument është përpunuar mirë dhe nga njerëz kompetent. Meqenëse ka me shkuar në diskutim publik unë nuk do ta zgjati sepse kontributin do ta japim gjatë diskutimit publik.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, e falënderoj Ibrahimin për prezantimin e kësaj Draft-Rregullore. Ky dokument ka me shkuar në diskutim publik, por po dua të them se sot fëmijët kanë kushte më shumë, sidomos përmes telefonit në rrjetet sociale, që kanë një ndikim shumë të madh. Unë jam që ti rekomandojmë Kuvendit që ta qojë në diskutim publik.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -V- për vitin 2020, të mbajtur më: 08.07.2020, unanimitisht i rekomandon, Kuvendit të Komunës së Shtimes aprovimin e Draft-Rregullores Komunale për mbrojtjen e fëmijës, pas diskutimit publik.**

Pika 3

Informatë nga ZKKK-ja për aktivitetet

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Gjatë kësaj periudhe kemi pas pak aktivitete, por kjo nuk do të thotë se ne kemi ndenjur kot. Kemi krijuar një data bazë duke futur të gjitha të dhënat sa i përket komunitetit pakicë. Kemi bërë një analizë të aktiviteteve sa i përket shpërndarjes së pakove ushqimore

dhe higjienike gjatë kohës së Pandemisë KOVID19. Janë ndihmuar përveç ndihmave edhe me 560 pako ekstra, për familjet e komunitetit pakicë, çka nënkupton se e kalojmë shifrën prej 2200 pakove totale për komunitetin pakicë. Janë mbuluar të gjitha familjet. Kemi dërguar dy kërkesa te IOM-i për projektin e ndriçimit publik për në fshatin Gjyrkovc dhe Vojnovc, ku edhe Komuna duhet të participojë me 20%, dhe ne mendojmë se ky projekt do të realizohet.

z.Muhamet Ademaj; E falënderoj Ibrahimin për këtë informatë. Më erdhi mirë që kanë krijuar një data bazë për të dhënat e përgjithshme për komunitetin pakicë. Unë kam një kërkesë për shpërndarësit e ndihmave që ata të mos shpërndajnë pako me fotografi të partive politike sepse mund të ndikojnë keq te fëmijët. Kemi një raport nga Kryetari për ndihmat e dhëna me 2366 pako ushqimore e higjienike.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Po ndërlihem edhe unë këtu, se në kohën më të vështirë të Pandemisë, ne kemi punuar pa u ndalë në shpërndarjen e ndihmave për familjet nevojtare. E falënderoj Komunën që na ka dalë në ndihmë, po ashtu i falënderoj edhe donatorët që kanë sjellë ndihma mjaft shumë.

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15.22 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija

